

Shërbimit Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat

Shpall funksionin e lirë për konkurrim në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme.

Në mbështetje të neneve 3 pika a, 21 dhe 76 e vijues dhe 86 të Ligjit Nr.70/2014” Për Shërbimin Për Çështjet e Brendshme Dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe bazuar në Urdhrin Nr. 579, datë 26.10.2018, “Mbi miratimin e Strukturës dhe Organikës të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme” si dhe neneve 107, 108 e vijues të Rregullores së Shërbimit Për Çështjet e Brendshme Dhe Ankesat, miratuar me Vendim Nr.829 , datë 03.12.2014 , të Këshillit të Ministrave.

1.Shpalljen e një funksioni të lirë për konkurrim në strukturat e Drejtorisë Rajonale Tiranë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat

- (Një) funksion organik, Shef Sektori i Sektorit për Trajtimin e Ankesave në Drejtorinë Rajonale Tiranë (pa gradë)
 - a. Arsimi i lartë, “Master i Shkencave” në Drejtësi.
 - b. Të ketë njohuri të gjuhës angleze
 - c. Të përdorë programet bazë të punës në kompjuter.
 - d. Të ketë aftësi të mira komunikuese
 - e. Të jetë i gatshëm të caktohet me shërbim kudo, brenda territorit të vendit.

2. *Periudha e aplikimit fillon me datë 02.11.2018 dhe përfundon më datë 07.11.2018.*